

VENDIM
Nr. 151, datë 25.7.2024

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 254, DATË 23.8.2023,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘G.S.K.’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 mw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 781/4 prot., datë 24.7.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.8.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2mw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 23.8.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “G.S.K” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2mw, për një afat 25-vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri në datën 23.6.2024.

- ERE, në vijim edhe të ndjekjes së zbatimit të kushteve të vendimit nr. 254/2023, me shkresën nr. 781 prot., datë 18.3.2024, i kërkoi shoqërisë informacion në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 781/1 prot., datë 25.3.2024, ka depozituar vendimin nr. 11, datë 26.12.2023, “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin ‘Ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2mw dhe veprave ndihmëse’, me vendndodhje në Njësinë Administrative Dermenas, Bashkia Fier”, gjithashtu ka informuar se është në proces të marrjes së lejes së ndërtimit, prandaj nuk ka filluar ende punimet.

- Duke qenë se shoqëria depozitoi dhe bëri me dije vetëm sa më sipër referuar, ERE, me shkresën nr. 781/2 prot., datë 3.7.2024, i solli në vëmendje detyrimet e kushteve të vendimit, e gjithashtu depozitim të VNM-së së rinovuar, pasi afati i vlefshmërisë ka qenë deri në datën 23.6.2024.

- Në përgjigje, shoqëria, me shkresën nr. 781/3 prot., datë 9.7.2024, ka depozituar informacion se ende nuk i është zbardhur leja e ndërtimit dhe si e tillë nuk ka nisur ende punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik. Për sa i përket VNM-së, shoqëria informon se ka aplikuar për rinovimin e saj dhe sapo të jetë pajisur do ta depozitojë atë në ERE.

- Aktualisht, duke marrë në konsideratë që ka përfunduar VNM-ja dhe subjekti ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet por ka aplikuar për rinovimin e VNM-së, por ende nuk e ka depozituar atë, vlerësohet të ndryshohet pika 2, e vendimit të Bordit nr. 254/2023, duke i vendosur kushtin shoqërisë përpara se të fillojë veprimtarinë e operimit/ushtrimit të energjisë elektrike, shoqëria “G.S.K” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e rinovuar.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 254/2023, ndryshon dhe bëhet:

“2. Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike, shoqëria “G.S.K” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e rinovuar.”.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 254/2023, ndryshon dhe bëhet:

“3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti